



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

**SHTOJCË SQARUESE PËR DOKUMENTET E PROCEDURËS SË KONCENSIONIT
PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE
TRANSFERIMIN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË VLORËS (VIA)**

Autoriteti kontraktues, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 22/2021, datë 15.01.2021 me objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së konkurrimit “E hapur” me objekt: Dhënie me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA), REF-46571-12-19-2019 me vlerë të parashikuar 86.638.359 Euro (pa TVSH), përgatiti shtojcën me sqarimet teknike të kërkuara nga operatori ekonomik ankimues, në lidhje me përcaktimet në lidhje me kategorinë e aeroportit, si vijon:

Sipas ICAO Codi i referencës së një Aerodromi është një kombinim i numrave dhe germave. Ky lloj kategorizimi është përfshirë në Aneksin 14 të ICAO dhe ka për qëllim thjeshtesimin e procesit nëse një avion mund të ulet në një aerodrom të përcaktuar. Kodi numerik k atë bëjë me karakteristikat fizike të pistes sikurse është gjatësia dhe gjerësia e saj. Germa në këtë kod përcakton karakteristikën e avionit sikurse është gjerësia e kraheve dhe largësia e gomave të tij.

1. Ndetimi i pistave është i lidhur drejtpërdrejtë me Kodin e referencës së Aeroportit, i cili qartazi është parashikuar në kërkesat e tenderit ku në të cilin kërkohet të jetë 4E. Për më tepër duke ju referuar tabelave të mëposhtme

Code number	Aeroplane reference field length	Typical aeroplane
1	< 800 m	DE HAVILLAND CANADA DHC-6/PIPER PA-31
2	800 m but < 1200 m	ATR ATR-42-300/320/BOMBARDIER Dash 8 Q300
3	1200 m but < 1800 m	SAAB 340/BOMBARDIER Regional Jet CRJ-200
4	1800 m and above	BOEING 737-700/AIRBUS A-320

Code letter	Wingspan	Outer main gear wheel span	Typical aeroplane
A	< 15 m	< 4,5 m	PIPER PA-31/CESSNA 404 Titan
B	15 m but < 24 m	4,5 m but < 6 m	BOMBARDIER Regional Jet CRJ-200/DE HAVILLAND CANADA DHC-6
C	24 m but < 36 m	6 m but < 9 m	BOEING 737-700/AIRBUS A-320/EMBRAER ERJ 190-100
D	36 m but < 52 m	9 m but < 14 m	B767 Series/AIRBUS A-310
E	52 m but < 65 m	9 m but < 14 m	B777 Series/B787 Series/A330 Family
F	65 m but < 80 m	14 m but < 16 m	BOEING 747-8/AIRBUS A-380-800

Gjatesia e pistes per aerodrome me kode reference 4 duhet te jete 1800m ose me e gjate por nderkohe gjeria e pistes (Runway), rrugeve lidhese (taxiway) apo vendqendrimet te avioneve (Apron) duhet te jete e tille qe te mundesoj operimet e avioneve qe kane distancen e kraheve midis 52 m – 65m pa perfshire kete te fundit si dhe distancen e gomave midis 14m – 16m pa perfshire kete te fundit.

Nje tjetër element qe afekton gjatesine e pistes eshte pesha qe do te ngreje avioni perfshire edhe peshen e tij se bashku me karburantin qe mbart. Duke qene se ne project eshte planizuar qe operimet kargo do te konsiderohen si dhe duke ditur qe avionet kargo jane shume te rende per shkak te ngarkeses eshte parashikuar qe gjatesia e pistes ne fund te projektit do te jete 3200m, por kjo gjatesi do te arrihet gradualisht ne fazat e zhvillimit te aerodromit te Vlores.

Kushtet atmosferike jane nje element tjetër qe ndikon ne gjatesine e pistes. Temperaturat e larta kerkojne nje gjatesi piste me te gjate se sa temperaturat qe nuk i kalojne 25 grade. Duke qene se ne Vlore ku do te ndertohet aeroporti temperature verore shkojne deri ne 40grade kerkohet nje gjatesi piste me e larte se sa ajo e parashikuar ne tabelat e mesiperme.

Ne rast te eksperiences ne ndertimin pistave ne Aeroporte qe ekzistojne (shtim pistash per rritje kapaciteti) ose qe ndertohen nga fillimi (green field airport) kerkohet qe parametrat e pistes te plotesojne kerkesat per kodin e references se Aerodromit 4E ku gjatesia e pistes duhet te jete me shume se 1800m por pjeset e tjera te infrastruktures (taxiway, apron dhe safety strip) te mundesojne levizjen e avioneve me gjeresi krahash dhe distance te gomave te percaktuara sipas ICAO. Ky spjegim behet per te qartesuar kerkesen ne lidhje me kapacitetet teknike dhe nuk ndryshon kerkesat e vendosura ne specifikimet teknike (Aneks 12) per gjatesine e pistes

2. Ne rastin e rinovimit te pistave ekzistuese kemi nje shtesë tjetër ku per shkak te demtimit nga perdorimi, me qellim mos cenimin e sigurise se avionit kerkohet rinovimi i pistave i cili konsiston kryesisht ne rishtrim me asphalt te nje ose dy shtresave siperfaqesore dhe me rralle rinovimi i shtresave te thella qe perbejne pisten. Ne rast se aplikuesi deshmon kompetencen ne

rinovim pistash (dhe jo ne ndertim te tyre) ai duhet te listoje cdo piste qe ka rinovuar me kushtin qe pista te jete me asphalt dhe te perdorur nga avionet me turbine (jet engine aircraft) dhe ti perkase kodit te references se aerodromit 3B ose me shume

Ne rast se ofertuesi deshiron te demonstroje kompetencen e tij ne rinovimin e pistave ai duhet ti referohet cdo aktiviteti te kryer ne lidhje te bazuar ne kodin e references se aerodromit 3B ose ten je kodi reference me te larte duke filluar nga 1200 m e me shume.